

VENDIM
Nr. 72, datë 18.7.2013

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR DHËNIE UDHËZIMI PËR
IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të pikës 4.8 të Modelit të Tregut, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, pikës 3.1 dhe 3.16.4 të licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.7.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” për dhënie udhëzimeve për importin e energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Licencimit,

pasi konstatoi:

- OSSH-ja është përgjegjëse për importin e energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes;

- Se statusi i administrimit të përcaktuar në nenin 18 pika 4 germa “c” të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, është i përkohshëm;

- Gjendjen financiare të shoqërisë, duke pasur parasysh operimin në bazë të një skeduli të pagesave;

- Humbjet faktike në sistemin e shpërndarjes përllogariten rreth datës 14 të muajit pasardhës, që e bën prokurimin në bazë mujore të jetë më afër realitetit.

VENDOSI:

1. “CEZ Shpërndarje” të kryejë procedurat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbi baza mujore për periudhën gusht-dhjetor 2013.

2. “CEZ Shpërndarje” për prokurimin e energjisë elektrike mbi bazë mujore duhet të zbatojë procedurat e përcaktuara në rregulloren e prokurimit të energjisë elektrike nga ana e OSSH-së miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 42, datë 25.5.2009.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani